


Nevoja për dizajn Urban në Kosovë



Hyrje

Planet zhvillimore komunale dhe urbane nevojiten në mëyrë urgjente për udhëheqjen e zhvillimit urban dhe rural në Kosovë. Shndërrimi i këtyre planeve strategjike në intervenime reale që përmirësojnë ambientin urban kërkon propozime të detajuara të dizajnit urban dhe të ambientit. Karta e Leipzigut për qytetet e qëndrueshme të Evropës (Ministrat e Planifikimit Hapësinor të BE-së, Maj 2007) konsideron “krijimin dhe garantimin e hapësirave të kualitetit të lartë ... të jetë e një rëndësie kryesore për forcimin e konkurrencës së qyteteve evropiane”. Kjo fletushkë e trajton këtë deklaratë nga perspektiva e Kosovës – pse vlen kjo këtu njëjtë sikur edhe në çdo vend tjetër të Evropës dhe cila është domethënia e saj. Viteve të fundit kemi qenë dëshmitarë të një rritjeje të shpejtë të popullatës së qyteteve të Kosovës, më së shumti në Prishtinë, e cila ka dyfishuar madhësinë që nga fundi i konfliktit. Ndryshimi fizik është zhvilluar në mënyrë paralele me ndryshimin social pasi që me urbanizim ka ardhur deri te shkatërrimi i lidhjeve klanore dhe familjare. Infrastruktura, sic janë rrugët, hapësirat publike dhe shkollat, por poashtu edhe uji, kanalizimi dhe rrjeti elektrik, është munduar ti përgjigjet kërkesave të gjithnjë e më shumë njerëzve me pritje gjithnjë e më të mëdha. Këto kërkesa dhe pritje janë duke rritur konkurrencën për hapësirën në qytet, ku dëshira për lehtësimin e mobilitetit personal është në fillim të agjendës së shumicës së vendimmarrësve. Ndoshta një nga shprehjet më kryesore të kësaj janë rrugët e Prishtinës dhe të qyteteve tjera të Kosovës, të cilat janë të bllokuara nga komunikacioni dhe pushtojnë gati gjithë hapësirën ndërmjet mureve të ndërtesave. Kjo është një çështje kryesore kur dihet se rrugët dhe hapësirat e hapura përbëjnë zakonisht afro 20% të shumicës së qyteteve. Këto janë forumi kryesor për bashkëveprimin social, ato lidhin vendet në të cilat duhet të arrijmë për plotësimin e nevojave tona (shkolla, puna, përkujdesja shëndetësore, dyqanet etj.) dhe paraqesin perspektivën

Shndërrimi i hapësirave në vende

Dizajni urban: sfida

Dizajni urban tenton që t'u mundësojë njerëzve të përfitojnë më shumë nga rrethina e tyre. Ndryshimi i raportit jo të shëndoshë të përshkruar më lart kërkon dizajnimin e ndërtesave dhe hapësirave në qytete në atë mënyrë që të pajtojë kërkesat kundërtëse dhe t'u mundësojë njerëzve të realizojnë një rreth të gjerë të nevojave të tyre. Kjo do tu mundësonte njerëzve të krijojnë lidhje të reja si me njëri tjetrin ashtu edhe me rrethinën e tyre dhe do të mund të ndihmonte që ndikimet negative të përjashtimit social, të marrëdhënieve të brishta ekonomike dhe të shkatërrimit fizik të mbesin anash. Dizajni urban tenton të krijojë vende me domethënie për njerëzit që i shfrytëzojnë, t'u ofrojë njerëzve mundësi për të bërë gjëra që ju nevojiten për të gëzuar një kualitet të lartë të jetës. Megjithatë, definimi i nevojave të njerëzve nuk është gjithmonë i lehtë. Si individ dhe komunitet, nevojat e njerëzve dallojnë dukshëm. Është e mundur që këto të ndryshojnë me kohë edhe mes njerëzve. Në atë se çka i nevojitet dikujt në një kohë të caktuar ndikon gjinia, mosha, edukata, përvoja, vlerat dhe madje edhe koha e ditës.

Dizajnimi i vendeve që janë të rëndësishme për secilin do të thotë dizajnimi i vendeve që mund të shfrytëzohen në mënyra të ndryshme nga më shumë njerëz. Hapësira urbane është tejet e çmueshme për t'u shfrytëzuar vetëm për një destinim. Në dizajnin urban, sikur edhe në natyrë, më si miri është të shmangët monokultura. Dizajni i mirë nuk kushton dukshëm më shumë, e as nuk merr më shumë kohë për t'u realizuar se sa dizajni i keq. Dëshira e arritjes së këtyre qëllimeve në Kosovë është e dukshme, por masa në të cilën kjo mund të arrihet varet nga dy faktorë kyç. Mbase më me rëndësi është aftësia për **krijimin e një kulture të dizajnit urban**. Ne të gjithë ndikojmë në kualitetin e rrethinës sonë, nga kryetarët e komunave dhe

planerët të cilët marrin vendime të mëdha, deri te njerëzit që kalojnë nëpër rrugë dhe buzëqeshja apo qeshja e të cilëve në moment e ndritë hapësirën, apo një individ i cili hudh mbeturinat në rrugë apo parkon automjetin në trotuar. Është thelbësor vetëdijësimi i njerëzve për vlerësimin e hapësirës së përbashkët, për pranimin e kontributit të saj në jetën e njerëzve dhe dhënia e mandatit demokratik qyteteve për t'i bërë përmirësimet dhe për të paguar për ato. Kjo mund të duket si kërkesë e madhe por udhëheqja vizionare dhe programet e koordinuara të informimit, edukimit dhe punëve publike kanë ndryshuar kulturën e qyteteve (dhe kanë krijuar përfitime ekonomike) në vende të ndryshme si në Bogotë në Kolumbi, Kopenhagen në Danimarkë, Melbourn në Australi dhe Tiranë në Shqipëri.

Së dyti, dhe shumë e lidhur me pikën e parë, është **zhvillimi i një ndjenje unike kosovare të dizajnit urban**. Në fund të ditës, importimi i dizajnerëve urban nga jashtë nuk është i qëndrueshëm, pa marrë parasysh se sa të mirë janë këta dizajnerë. Përtej disa rregullave themelore që kanë të bëjnë me qasjen, komoditetin dhe sigurinë, ajo që është 'e mirë' në masë të madhe varet nga specifikat kulturore. Njerëzit të cilët më së miri mund të kuptojnë këtë ndjenjë të vendit janë njerëzit të cilët për cdo ditë janë në atë vend. Nëse bëhen këto ndryshime, qytetet e Kosovës mund të bëhen vende brenda të cilave njerëzit e sapo-urbanizuar do të kenë gjasë më të mira për të përparuar dhe për të shfrytëzuar më mirë potencialin e tyre. Është pjesë e rëndësishme e nxerrjes së maksimumit nga pasuria më e cmuar e Kosovës: njerëzve të saj dhe duke ju ofruar ndihmën për të konkuruar në mënyrë të barabartë me qendrat tjera evropiane.

Cka është bërja e vendeve?

Bërja e vendeve është qëllimi i dizajnit urban. Ky është emërtimi i një procesi të dizajnit që tenton t'u mundësojë njerëzve që jetojnë në qytete të përfitojnë më shumë nga rrethina e tyre. Të përfitojnë më shumë mundësi rreth zonës së tyre, të kenë më shumë mundësi të takojnë njerëz, më shumë mundësi për të mësuar, për tu rritur, për tu shprehur, të gëzojnë bukurinë dhe të mallëngjehen, frymëzohen dhe të lidhen me njëri tjetrin dhe me rrethinën e tyre. "Bërja e vendeve" e bën këtë duke intervenuar në mbretërinë publike për krijimin e vendeve që lehtëson bashkëveprimin e njerëzve me njëri tjetrin dhe me rrethinën e tyre në atë mënyrë që mund të realizojnë më shumë nga nevojat e tyre se sa që do të ishte rasti në të kundërtën.

Hapësirat u mundësojnë njerëzve të bëjnë gjërat themelore që janë minimumi i kërkesave funksionale të hapësirave të përbashkëta të qytetit, si p.sh. mundësimi që njerëzit të shkojnë në mënyrë të sigurt dhe volitshëm në punë, shitore apo shkollë, ndërsa vendet ju mundësojnë atyre që veç kësaj të zgjedhin një sërë bashkëveprime opcionale që janë të rëndësishme për nevojat dhe vlerat e tyre personale. Bërja e vendeve ka të bëjë me atë se si funksionojnë vendet dhe së në çfarë mënyre njerëzit që i shfrytëzojnë i ndiejnë ato. E njejtja tenton që të sigurojë që të dizajnojmë ndërtesa dhe hapësira të reja, apo të ri-dizajnojmë hapësirat ekzistuese në atë mënyrë, që të ndihen të sigurt, të rehatshme dhe interesante.



Një shembull i trilluar i një lloji të hapësirës që mund të gjindet në shumë qytete të Kosovës, i cili është i pasigurt, joatraktiv dhe ofron pak për rrethinën dhe i cili shfrytëzohet vetëm për parkim joformal.




Zona e njejtë si vend, duke ilustruar se si ajo mund të shndërrohet në një zonë atraktive, ftuese që shfrytëzohet për shumë qëllime shoqërore dhe rekreative dhe e cila i kontribuon rrethinës së saj.

Parimet në bërjen e vendeve

Gjatë dizajnit të një zone publike, fakti se a do të bëhet një vend i çmueshëm zakonisht varet nga aplikimi i parimeve të përshkruara më poshtë. Këto mund të shfrytëzohen edhe si tabelë kontrolluese. Posa të shfaqet dizajni, dizajnerët duhet të kthehen te këto parime për të siguruar se janë ende duke u ap

likuar të gjitha këto dhe se ndjekja e një objektivi nuk paraqet kompromis për objektivat tjerë. Nuk janë të gjitha këto brenda përshkrimit të punës së dizajnerëve, megjithatë dizajnet duhet të jenë të shoqëruara me një raport me të cilin theksohet rëndësia e tyre dhe nevoja që të sigurohet se në fazat e ardhshme të merremi me këto çështje.

Parimi 1 Optimizimi i konektivitetit - ashtu që njerëzit të mund t'i qasen lehtë vendit dhe përpjekja dhe bezdia të mos jenë më të mëdha se përfitimet potenciale.



Një nga karakteristikat e konektivitetit është dizajni i vendeve që mund të qasen në mënyrën më të lehtë të mundshme.

Parimi 2 Rritja e sigurisë – ashtu që vizitori që shfrytëzon vendin nuk do t'i ekspozohet dëmtimit apo frikës

Parimi 3 Lehtësimi i qëndrueshmërisë - ashtu që vendi të mund të shfrytëzohet lehtë nga më shumë njerëz me nevoja dhe pritje të ndryshme.



Një shembull i qëndrueshmërisë është sistemi i qëndrueshëm i drenazhit/kullimit – sikur edhe ky shembull nga Perth, Australia – këto mund të ndihmojnë për të definuar vendin, të shtojnë interesimin dhe të bëjnë një shfrytëzim më të qëndrueshëm të ujit.



Parimi 4 Shtimi i komoditetit – ashtu që vendi të mund të shfrytëzohet pa ndonjë stimulim të padëshiruar emocional apo fizik (si p.sh. ndenja jokomode e të ftohtit, nxehtit apo pamundësia për tu ulur).



Një nga mënyrat e shtimit të komoditetit është ofrimi i vendeve atraktive me strehë për ulje, relaksim dhe pushim përgjatë rrugëve të këmbësorëve.

Parimi 5 Mbrojtja ndaj përvetësimit – ashtu që vizitorët mos të ndihen se po hyjnë në një territor të dikujt tjetër.

Ky lloj i hapësirës ofron një shembull të përvetësimit pasi që vizitorët që kalojnë nëpër të kanë përshtypjen e hapësirës si rrugë lineare dhe nuk do të kenë ndjenjën se janë në një vend të veçantë. Si pasojë, shfrytëzuesit e rrugës në mënyrë të paqëllim të do të dominojnë hapësirën duke e "përvetësuar" nga shfrytëzuesit tjerë.



Megjithatë, nëse kjo hapësirë ridizajnohet sikur është paraqitur më lart, vizitorët që kalojnë nëpër të, do të jenë të vetëdijshëm që po kalojnë nëpër një vend të veçantë dhe do të jenë më pak e mundshme që ata të dominojnë me këtë hapësirë, me çka edhe minimizohet masa me të cilën ata e përvetësojnë këtë hapësirë për vete.

Parimi 6 Ofrimi i mundësisë që njerëzit të mund të shprehen – ashtu që ata të mund të gjejnë mënyra për ti kontribuar rrethinës së tyre, të shtojnë karakter dhe të ushtrjnë aftësitë e tyre artistike, kulturore dhe sociale.



Një nga mënyrat kryesore që hapësira e hapur të mundësojë njerëzve të shprehen është duke ofruar vende ku njerëzit mund të takohen, të mund të shohin njerëzit tjerë dhe të shihen prej tyre.

Parimi 7 Përforcimi i përjetimit të vendit – ashtu që vizitorët të jenë të vetëdijshëm që po hyjnë në një vend special dhe të vecantë duke shprehur dicka nga karakteri i zonës. .



Një shembull i përkrahjes së sensit të zonës së vendit është dizajnimi i hapësirave që ofrojnë pamje atraktive në vendet historike.

Parimi 8 Shto kënaqësinë – ashtu që shfrytëzimi i vendit të jetë dëfryes, interesant dhe stimulativ



Parimi 9 Shfrytëzimi i energjisë natyrore (si dielli, hija, era apo drenazhi) – ashtu që vendit të mos i nevojitet energjia plotësuese e krijuar nga njeriu për të qenë i shfrytëzueshëm.



Drita, hija, ngjyrat, aroma e luleve dhe ndryshimet sezonale janë shembuj se si energjitë natyrore mund të kontribuojnë në përjetimin e hapësirës, sikur edhe ky shembull nga Australia.



Parimi 10 Ofrimi i mirëmbajtjes së qëndrueshme – ashtu që vendi të mund të vazhdojë edhe më tutje t'i kontribuojë njerëzve, të cilët e shfrytëzojnë për një kohë të gjatë.

Këto parime dhe teknikat, me të cilat këto mund të aplikohen, do të mbulohen me Udhëzimet e Dizajnit Urban të MuSPP (PMPHK), me shembuj dhe praktika konkrete, si ekzistuese ashtu edhe të propozuara. Jeni të ftuar të mendoni dhe të punoni me ne për të shndërruar hapësirat e Kosovës në vende të jetueshme dhe të kënaqshme.

Nuk ekziston ndonjë recept për bërjen e vendeve, megjithatë përvoja nga Evropa dhe jashtë saj sugjeron që aplikimi i principeve të lartpërmendura mund të ndihmojë në arritjen e propozimeve që mund të rezultojnë me qëllimet e përshkruara më lart. Duke marrë parasysh se zonat urbane janë trashëguar si komplekse dhe kanë dimension fizik (d.m.th. forma e ndërtimeve) dhe dimension social (d.m.th. se si njerëzit veprojnë dhe cka ndëjnë në lidhje me rrethinën e tyre) krijimi i vendeve të mira urbane kërkon që procesi të zhvillohet në rrugë të drejtë, së paku cka i përket marrjes adekuatë në konsideratë të dimensionit shoqëror dhe fitimi i rezultateve të sakta, ashtu që kualiteti i krijuar në hapësirë të jetë i rëndësishëm dhe i dobishëm për njerëzit që do të kenë mundësinë ta përjetojnë. Procesi i bërjes së vendeve zakonisht përfshinë fazat vijuese:

1. Kuptimi i sfidës ashtu që të identifikohet dhe të fokusohet problemi. Për këtë kërkohet kuptimi i vendit si konstrukt fizik dhe social, duke identifikuar se si për momentin njerëzit shfrytëzojnë atë vend si dhe cila është përmbledhja e kërkesave. Kjo zakonisht shprehet nëpërmjet një analize të vendit dhe një eksplorimi të qartë dhe grafik të çështjeve që ndikojnë në dizajn. Kjo zakonisht kërkon integrimin e inputeve nga një numër i disiplinave.

2. Krijimi dhe testimi i vizionit, ashtu që të vendoset një drejtim i dizajnit me qëllim që të gjithë pjesëmarrësit të mund të pajtohen me të dhe të marrin pjesë në zhvillimin dhe implementimin e tij. Kjo kërkon krijimin e një agjende të përbashkët të dizajnit me pjesëmarrësit dhe krijimi i një vizioni që në mënyrë

të qartë adreson shqetësimet e komunitetit dhe të pjesëmarrësve si dhe plotëson kërkesat e një planifikimi dhe dizajni të mirë. Kjo zakonisht shprehet nëpërmjet një “vizioni” që në mënyrë të qartë adreson çështjet e identifikuara në fazën para-prake, për përmirësim dhe konfirmim nga ana e pjesëmarrësve.

3. Shndërrimin e vizionit në plan ashtu që drejtimi i dakorduar të mund të shndërrohet në një bashkësi të propozimeve reale dhe të arritshme. Kjo kërkon kuptimin e pasojave të formës së ndërtuar së vizionit dhe pajtimin e tyre me një bashkësi të koordinuar të propozimeve. Kjo zakonisht shprehet nëpërmjet një serie propozimesh të cilat në mënyrë të qartë identifikojnë intervenimet dhe adresojnë çështjet dhe vlerësimin e vendit nga faza e parë.

4. Të mundësohet që kjo të ndodhë ashtu që plani i dokumentuar të mund të shndërrohet në veprime në terren, të cilat mund të arrijnë deri te rezultatet që do t'i kontribuojnë jetesës në qytet. Kjo kërkon që të qartësohen përgjegjësitë e secilit dhe të sigurohet që burimet në kuptim të kohës, mjeteve financiare dhe zotimit të jenë në dispozicion. Këto zakonisht janë të shprehura në pjesën e implementimit.

5. Kontrolli i kualitetit dhe mbrojtja e kontributit të saj ashtu që propozimet kur implementohen, të mund të vazhdojnë të plotësojnë nevojat e njerëzve të cilat i përjetojnë ashtu si ndërrojnë nevojat e tyre dhe ashtu si vjetërohen elementet e ndërtuara për shkak të kohës. Kjo zakonisht kërkon që projekti të mundësojë mirëmbajtjen, vlerësimin dhe përmirësimin e vijueshëm.



Komunikimi i një vizioni për zhvillim me një perspektivë reale është një metodë efektive me të cilën arrihet që njerëzit të marrin pjesë dhe të krijojnë entuziazmin për implementimin e një dizajni.

Përfitimi nga kualiteti i lartë i dizajnit urban

Një hulumtim nga Britania e Madhe (komisioni për arkitekturë dhe mjedisit të ndërtuar dhe shkolla e planifikimit Bartlet, 2001), vuri në pah se investimi në mjedisin urban jep përfitime të mëdha sociale, ekonomike dhe ekologjike, e në veçanti:

- Ngrit vlerat ekonomike, sociale dhe mjedisore si dhe jo doemos kushton apo merr kohë më shumë
- Siguron ngritjen e investimeve për investitorët dhe sipërmarrësit
- Përforon performancën dhe shton kënaqësinë e fuqisë punuese si dhe ngrit prestigjin e shfrytëzuesve
- Sjell përfitime ekonomike duke hapur kështu investime të reja
- Sjell mundësi dhe regjenerim të suksesshëm
- Ndihmon në ofrimin e vendeve më të qasshme dhe të pëlqyera nga të gjithë
- Përfitojnë të gjithë pjesëmarrësit- investitorët, shfrytëzuesit, autoritetet publike dhe përdoruesit ditorë të këtyre zhvillimeve.

"Aftësia e njerëzve për punë, t'i tubojnë fëmijët, mendojnë, mësojnë të shoqërohen dhe ngelin të shëndoshë është përmirësuar jashëzakonisht nga ambientet e favorshme dhe të përgjegjshme si dhe të papenguara nga askush." ("Qytetet që shkatërrojnë vetveten", në Arkitektura e Komuniteteve, Nick Wates dhe Charles Knevit 1987).

Shembuj të mirë të bërjes së vendeve në Kosovë



Kulla e Gjakovës

Një zonë atraktive e përdorur nga kafenetë dhe kompleksi universitar, ku lejohet përdorimi i veturave mirëpo shkalla dhe dizajni i detalizuar i ndalon ato që të dominojnë hapësirën. Ndërtesa e gurit/reproduksion i Kullës ofron një përfundim interesant të panoramës duke shikuar teposhtë rrugës dhe thekson rëndësinë qytetareske të hapësirës me anë të vetive të lartësisë së saj, masës si dhe materialeve kontrastuese nga gurët dhe dominimin e objekteve nga druri.



Bregu lumor i Prizrenit

Shëtitorja përgjatë bregut lumor iu lejon njerëzve të ecin pranë lumit atraktiv, ku ata mund të dëgjojnë dhe gjithashtu të shohin e të kënaqen me pamjet tërheqëse të kompozicionit të objekteve, të lumit afër paisazhit si dhe të maleve të largëta. Vëmendje e veçantë në hollësi i jep ajo se materialet e përzgjedhura të zonës e plotësojnë karakterin e trashëgimisë së këtij qyteti tërheqës.

Impressum

Kjo fletushkë është iniciativë e MuSPP/UN-HABITAT, si vegël komunikimi që ka për qëllim ngritjen e vetëdijes lidhur me Dizajnin Urban dhe Hapësirëat Publike, si një komponentë e rëndësishme në zhvillimin strategjik, hapësor dhe urban. Grupi i synuar i fletushkës është grupi i palëve me interes në planifikimin e nivelit qendror dhe lokal, duke përfshirë edhe organizatat e shoqërisë civile, universitetin, organizatat profesionale etj.

Në këtë fletushkë kontribuan

Teksti: Jenny Donovan, Eksperte e MuSPP-it për Dizajn të Hapësirave Publike dhe Urbane; **Redaktorë:** Krystyna Galezia, u.d e udhëheqëses së zyrës së UN-HABITAT-it në Kosovë, Frank D'hondt, Koordinator i Planifikimit Hapësor në MuSPP, Lumnije Gashi, Zyrtare për Informim dhe Komunikim në MuSPP; **Dizajni dhe faqesja:** Astron Mahmutaj, Asistent për Informim dhe Komunikim në MuSPP

Kontakti: info@unhabitat-kosovo.org

Për më shumë informata për MuSPP/UN-HABITAT në www.unhabitat-kosovo.org

Programi për Mbështetjen e Komunave në Planifikim Hapësor në Kosovë i UN-HABITAT-it fincuar nga  Sida. Pikëpamjet e shprehura në këtë fletushkë u përkasin autorëve dhe nuk i përkasin UN-HABITAT-it, Sida-s apo Qeverisë Suedeze.

Bashkë Bëjmë Qytete më të Mira